

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, në përbërje prej kryetarit të trupit gjykues Ylber Shurdhiqi dhe anëtareve Basri Reçica dhe Pehlivan Zhuri, duke vendosur në çështjen juridike kontestimore të paditësit Sh.R. nga fshati B., Komuna e P.1, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson G.A., avokat nga P.1, kundër të paditurës K.R.nga fshati B., Komuna e P.1, për besimin, ruajtjen, kujdesin dhe edukimin e fëmiut, në seancën e shqyrtimit kryesor jo publik, me datë 11.10.2018, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET SI E BAZUAR kërkesëpadia e paditësit Sh.R.nga fshati B., Komuna e P.1, NDRYSHOHET pika II e dispozitivit të aktgjykimit të formës së prerë të Gjykatës Themelore Prishtinë–Dega në Podujevë, C.nr.198/16, dt.19.04.2016, dhe tani gjykohet si në vijim, fëmijët e mitur E.R.1, i lindur me datë ..., në P.1, E.R.2 e lindur me datën ..., në P.1, E.R.3 e lindur me datën ..., në P.1 si dhe S.R. e lindur me datën ..., në P.1, i besohen në ruajtje, mbajtje dhe edukim babait–paditësit Sh.R..

II. Pjesa tjetër e dispozitivit të aktgjykimit C.nr.198/16, dt.19.04.2016, mbetet e pa ndryshuar.

III. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Paditësi, përmes të autorizuarit të tij, me datë 14.02.2017, ka parashtruar padi në gjykatë, lidhur me ndryshimin e aktgjykimit sa i përket besimit të fëmijëve. Me anë të padisë ka theksuar se me aktgjykimit të Gjykatës Themelore Prishtinë–Dega në Podujevë, C.nr.198/2016, dt.19.04.2016, e kanë zgjedhur martesën e lidhur me datë ... pranë Zyrës së Gjendjes Civile në Ll., Komuna e P.2. Ndër të tjera ka theksuar se në bazë të aktgjykimit në fjalë, fëmijët e mitur E.R.1, i lindur me datë ..., në P.1, E.R.2 e lindur me datën ..., në P.1, E.R.3 e lindur me datën .., në P.1 dhe S.R. e lindur me datën ..., në P.1, i janë besuar në ruajtje, kujdes, dhe edukim të paditurës–nënës K.R.. Kurse me parashtresën e datës 31.05.2017, e ka prezicuar kërkesëpadinë, duke theksuar se kërkojnë nga gjykata që të bëjë ndryshimin e aktgjykimit lidhur me besimin e fëmijëve, kjo për faktin se kanë ndryshuar rrethanat, pasi që paditësi tani jeton në Gj., dhe në prani të këtyre rrethanave i njëjti i ka kushtet më të mira ekonomike, për ruajtjen, rritjen, ushqimin dhe edukimin e fëmijëve. Po ashtu ka kërkuar nga gjykata që gjatë senacave gjyqësore ta merr mendimin e fëmijëve të cilët janë të aftë të shprehin pikpamjet dhe pretendimet e tyre lidhur me atë se me cilin prind dëshirojnë të qëndrojnë.

Ndërsa gjatë shqyrtimit kryesor dhe në fjalën përfundimtare i autorizuari i paditësit ka deklaruar se mbetem në tërësi pran padisë duke shtuar se pas pranimit të anamnezës sociale, ndaj të njëjtës nuk kam vërejtje, pasi që konsideroj se në të njëjtën është përshkruar në detaje gjendja faktike, ku është marrë mendimi i fëmijëve, të cilët kanë deklaruar se tani e tutje dëshirojnë që të bashkohen me babain e tyre në Gj. dhe që i njëjti ti ketë nën përkujdesje, ruajtje, ushqim dhe edukim. Gjithashtu ka theksuar se paditësi ka biznes të vetin privat në Gj., ku nga ky biznes realizon të ardhura prej ... deri ... Euro në muaj, se ka banesë me qera në sipërfaqe prej ... m², që nënkupton se i njëjti ka mundësi që tu plotësoj kushtet lidhur me rritjen, edukimin dhe shkollimin, më mirë se e paditura-nëna e tyre.

Shpenzimet e procedurës nuk i ka kërkuar.

E paditura gjatë shqyrtimit kryesor ka deklaruar se është e pajtimit që të ndryshohet pika II e dispozitivit të aktgjykimit të formës së prerë të Gjykatës Themelore Prishtinë–Dega në Podujevë, C.nr.198/2016, dt.19.04.2016, ashtu që është pajtuar që fëmijët e mitur tani e tutje ti besohen në ruajtje, edukim dhe shkollim paditësit–babait të tyre, kjo për faktin se e njëjta nuk po mundet që të kujdeset për fëmijë, për arsye se nuk i ka kushtet e mira ekonomike, nuk punon dhe si rezultat i kësaj nuk po mundet ta përmbush obligimin që del nga pika II e dispozitivit të aktgjykimit, ndryshimi i së cilët është kërkuar, andaj në prani të këtyre rrethanave e paditura ka theksuar se paditësi Sh.R. do të kujdeset më mirë për fëmijët e tyre të përbashkët.

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike lidhur me çështjen konkrete juridike, gjykata në procedurën e provave të shqyrtimit kryesor–jo publik të dt. 11.10.2018, sipas propozimit të palëve ka administruar provat dhe atë: aktgjykimin C.nr.198/16, i dt.19.04.2016, i plotfuqishëm me datë 19.04.2016, aktvendimi C.nr.198/16, i dt.12.12.2017, ekstrakti nga regjistri qendror i gjendjes civile me numër E 21264197, dt.13.02.2017, ekstrakti nga regjistri qendror i gjendjes civile me numër E 21264210, dt.13.02.2017, ekstrakti nga regjistri qendror i gjendjes civile me numër E 21264439, dt.13.02.2017, ekstrakti nga regjistri qendror i gjendjes civile me numër E 21264231, dt.13.02.2017, si dhe anamneza sociale me numër reference 952, dt.23.08.2018.

Gjykata pasi që bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjitha së bashku, mbështetur në dispozitat nga neni 8 i LPK-së, arriti në përfundim se në këtë çështje juridiko-civile duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, pasi që:

Në mes të palëve nuk ka qenë kontestuese se me aktgjykimin e Gjykatës Themelore Prishtinë–Dega në Podujevë C.nr.198/2016, i datës 19.04.2016, vërtetohet se ishte zgjidhur martesë me marrëveshje në mes të propozuesit Sh.R. dhe propozueses K.R., ashtu që fëmijët e përbashkët të mitur E.R.1, i lindur me datë ..., në P.1, E.R.2e lindur me datën ..., në P.1, E.R.3 e lindur me datën ..., në P.1 si dhe S.R. e lindur me datën ..., në P., i ishin besuar në ruajtje, edukim të mëtejshëm nënës së tyre K.R..

Në anamnezën sociale me numër reference 952 e datës 23.08.2018 e lëshuar nga Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale në Prishtinë, është përshkruar në mënyrë të detajuar gjendja ekonomike dhe sociale, rrethanat e banimit pas intervistimit dhe vizitave në familjet e paditësit dhe të paditurës si dhe pas bisedës edhe me fëmijët është propozuar që të ndryshohet vendimi i Gjykatës Themelore Prishtinë–Dega në Podujevë C.nr.198/2016, i datës 19.04.2016 dhe fëmijët e mitur E.R.1, E.R.2, E.R.3 dhe S.R., ti besohen në ruajtje, edukim, dhe emancipim babait biologjik Sh.H., pasi që për këtë është pajtuar edhe nëna e fëmijëve–e paditura K.R.dhe vetë fëmijët. Madje nga anamneza sociale kuptohet se fëmija i mitur E.R.1 që nga muaji maj 2018, ka bërë bashkimin familjar në Gj. me babain e tij–paditësin Sh.R..

Gjkata në seancën e datës 11.10.2018, ka marrë edhe deklarin e të miturës E.R.2, e cila ka deklaruar se jeton në fshatin B., së bashku me nënën e saj dhe dy motrat e vogla. Po ashtu ka deklaruar se nuk i kanë kushtet e mira, andaj kërkoj që të shkoj te babai, pasi që i njëjti është kujdesur në vazhdimësi për mua, pasi që i ka kushtet më të mira ekonomike.

Nga aktgjykimi Gjykatës Themelore Prishtinë – Dega në Podujevë C.nr.198/2016, i datës 19.04.2016, është vërtetuar se në atë procedurë propozuesi Sh.R.dhe propozuesja K.R.me marrëveshje kanë kërkuar nga gjykata zgjidhjen e martesës dhe gjykata në kuptim të dispozitave të nenit 68 të Ligjit për Familjen i Kosovës e ka zgjidhur martesës.

Dispozita e nenit 139, paragrafi 3 të Ligjit për Familjen i Kosovës përcakton “në rastet kur prindërit jetojnë të ndarë, janë të shkurorëzuar ose martesa e tyre është e anuluar me vendim të gjykatës ose të organit tjetër kompetent dhe fëmija i është besuar për ruajtje dhe edukim njërit prind, kujdesin prindëror e ushtron prindi të cilit i është besuar fëmija”. Në rastin konkret me aktgjykimin C.nr.198/2016, i datës 19.04.2016, fëmijët e mitur i janë besuar të paditurës K.R..

Pasi që sipas deklarimeve të autorizuarit të paditësit, palës së paditur dhe të mitures E.R.2, se nga koha kur është nxjerrur aktgjykimi rrethanat kanë ndryshuar gjykata ka shqyrtuar dhe vlerësuar me kujdes këto deklarime sikur që i ka vlerësuar edhe provat tjera që ndërlidhen me deklarin e palëve në procedurë të cilave ja fali besimin e plotë, ngase gjykata konstatoi se nga zgjidhja e martesës me aktgjykimin C.nr.198/2016, i datës 19.04.2016, e deri në paraqitjen e padisë në gjykatë për ndryshimin e këtij aktgjykimi kanë ndryshuar rrethanat, të cilat rrethana edhe patën ndikim në ndryshimin e aktgjykimit, pasi që kjo gjendje faktike është përputhur edhe me provat tjera, kjo për faktin se e paditura nuk e ka kundërshtuar ndryshimin e këtij aktgjykimi. Dispozitat e nenit 140, paragrafi 4, të Ligjit për Familjen i Kosovës përcakton “gjykata, me kërkesën e njërit prind ose të Organit të Kujdestarisë, do të ndryshojë vendimin mbi kujdestarinë, nëse këtë gjë e kërkojnë rrethanat e ndryshuara”, ndërsa paragrafi 5 i të njëjtit nen përcakton “mendimi i fëmijës, i cili është i aftë të japë pikëpamjet e tij/saj, do të merret parasysh nga gjykata në çdo procedurë që i përket atij. Mendimit të tij do t’i jepet pesha e duhur në pajtim me moshën dhe aftësinë e tij për të kuptuar”.

Dispozitat e cekur më lartë lejonë mundësin që gjykata me kërkesën e paditësit mund ta ndryshoj vendimin që fëmijët e mitur ti besohen në ruajtje, mbajtje dhe edukim prindit tjetër, ngase rrethanat mbi të cilat është bazuar vendimi kanë ndryshuar.

Andaj, nga të lartëcekurat dhe duke marr parasysh nevojat e fëmijëve të mitur, moshën e tyre si dhe mundësitë reale të përkujdesjes më të mirë nga ana e paditësit, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Vendimin që secila palë t'i bartë shpenzimet e veta, gjykata e mbështeti në dispozitën e nenit 450 të LPK-ës, pasi që nga asnjëra palë nuk kishte kërkesë për shpenzime

Me sa u tha më lartë, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-Departamenti i Përgjithshëm,
C.nr.3472/17, datë 11.10.2018

KËSHILLA JURIDIKE

Kryetari i trupit gjykues
Ylber Shurdhiqi

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh nga marrja e të njëjti, përmes kësaj gjykate për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.